



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242337
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714879

Ac.nr.10704/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Salluka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B..... R..... nga Prishtina, të cilin e përfaqëson i autorizuari J..... I....., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari L..... B..... avokat në Prishtinë, për kompensimin e dëmit në vlerë prej 26,273.80 euro, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1295/16, të datës 05.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pathemelta ankesat e paditësit B.... R..... nga Prishtina dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” sh.a. me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1295/16, i datës 05.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar 1295/15 të datës 05.11.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B..... R..... nga Prishtina, ashtu që ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” sh.a. me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 16,493.80 euro dhe atë: Në emër të dëmit jomaterial: për dhimbje fizike shumën prej 3,200.00 euro, për frikën e pësuar shumën prej 2,200.00 euro, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor 8,064.00 euro, për shëmtim trupor shumën prej 700.00 euro, gjithsej shumën prej 14,164.00 euro. Në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar shumën prej 420.00 euro, për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shumën prej 294.00 euro, për shpenzime të shërimit shumën prej 1,615.80 euro, gjithsej shumën prej 2,329.80 euro, me kamatë

prej 8 %, e cila në shumën e aprovuar në emër të dëmit jomaterial në lartësi prej 14,164.00 euro do të llogaritet nga data 05.11.2021 kur është marrë ky aktgjykim e deri në pagesën definitive, ndërsa në shumën e aprovuar në emër të dëmit material në lartësi prej 2,329.80 euro do të llogaritet nga data 08.06.2016 kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 1.469,20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumën e gjykuara, dhe atë në emër të kompensimit: për dhembje fizike shumën prej 2,000.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 2,000.00 euro, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 4,480.00 euro, për shëmtim shumën prej 1,300.00 euro, E PABAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe ta aprovojë në tërësi kërkespadinë e riprecizuar të paditësit sit ë bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjore, ka ushtruar ankesë edhe pala e paditur, të shkeljes esenciale të dispozitivit të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Aneksat e palëve ndërgjyqëse janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B..... R..... nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autoizuar, J... I....., avokat në Prishtinë, me datë 08.06.2016 ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” sh.a. me seli në Prishtinë për kompensim dëmi për shkak se me datë 26.03.2016, rreth orës 15:30 në rrugën magjistrale Glllogovc – Skenderaj në fshatin Tërstenik të komunës së Glllogovcit, ka ndodhur një aksident i komunikacioni, kur automjeti i tipit Ford Escort me targa 01-429-GL, të cilin e drejtonte L.... B....., i cili ishte duke lëvizur në drejtimin Skenderaj – Glllogovc, kur ka arritur në fshatin Tërstenik ka ndërmarr veprimin e tejkalimit pa u bindur që rrezikon të tjerët në komunikacion, me ç’rast i njëjti për shkak të tejkalimit të shpejtësisë së lejuar e ka humbur kontrollin mbi automjetin e tij duke kaluar në anën e kundërt të rrugës e më pas ka goditur automjetin Citroen me targa 01-787-DI, të cilin në atë moment e drejtonte paditësi B.....R..... Në këtë aksidenti paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Pas pranimit të ekspertizave mjekësore asaj të psikiatrisë (të punuar nga Dr. Sh..... H.....) dhe të ortopedisë (të punuar nga Dr. L.....K.....) i njëjti ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata ta detyroj të paditurën që

paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material t'ia paguaj shumën prej 27,473.80 euro dhe atë për dhimbje fizike shumën prej 5,200.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 4,200.00 euro , për zvogëlimi të aktivitetit përgjithshëm jetësor shumën prej 12,544.00 euro, për shëmtim trupor shumën prej 2,000.00 euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 420.00 euro, për ndihmën dhe për kujdesin e huaj shumën prej 294.00 euro dhe për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 1,615.80 euro. I njejtë ka sqaruar se nga shuma totale e shpenzimeve materiale gjatë kohës së shërimit prej 2,815.80 euro e ka zbritur shumën prej 1,200.00 € të cilën e paditura ia ka paguar paditësit në emër të paradhënies. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas listës së specifikuar të shpenzimeve në shumën e përgjithshme prej 1,469.20 euro.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë për nga baza, por vetëm për nga lartësia e saj. Më tej ka theksuar se shumata e kërkuara sipas precizimit të kërkesëpadisë janë tejet të larta krahasuar me natyrën e lëndimeve e që në bazë të dispozitave ligjore paditësit i takon kompensimi për kategorinë e dëmit jo material dhe material në vlerë prej 5,000.00 euro, shumë të cilën e paditura edhe ia ka ofruar paditësit në formë marrëveshje për të gjitha kategoritë e dëmit e që në këtë shumë është zbritur akontacioni në vlerë prej 1.200,00 euro për shpenzimet në emër të paradhënies për mjekim. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1295/16 të datës 05.11.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestues në mes të palëve është lartësia e kërkesëpadisë, për të gjitha format e kompensimit të dëmit. Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit ka aprovuar nxjerrjen e provave përmes ekspertizave mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Fillimisht mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësit, lidhur me natyrën e lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi dhe pasojat e tyre me datë 31.03.2021 e kanë dhënë Dr. Xh..... S..... – ortoped dhe Dr. Sh..... H..... Më pas poashtu sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit për shkak të dyshimit të tij se nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i paditësit në ekspertizën e datës 31.03.2021, mendimin dhe konstatimin me datë 21.09.2021 e ka dhënë edhe Dr. L.... K..... – ortoped. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar fare mendimin dhe konstatimin e Dr. L... K....– ortoped, atëherë gjykata edhe konstatimet e saj përkitazi me natyrën e lëndimeve dhe pasojave të tyre, i ka bazuar në ekspertizën në fjalë si dhe në ekspertizën e Dr. Sh.....H..... - psikiatër. Duke u bazuar në mendimet dhe konstatimet e ekspertëve gjykata vërtetoi faktin se paditësi në aksidentin e komunikacionit, ka pësuar thyerjen e bazës së kockave të teitrinës I, II, III të shputës së këmbës së djathtë, thyerje serike të brinjëve VI, VII, VIII dhe IX majtas, gjakmbledhje në mushkërinë e majtë, si dhe kontrakturë të nyjës talokrurale të majtë me hipotrofi të muskujve inferior të këtij

ekstremiteti, lëndime këto të cilat kategorizohen si lëndime të rënda trupore. Më tej, sipas këtyre ekspertizave Gjykata vërtetoi dhimbjet fizike që ka pësuar paditësi, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, pastaj frikën që ka përjetuar i njëjti dhe kohëzgjatjen e saj, faktin që si pasojë e aksidentit paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 17.92 % si dhe shëmtim në shkallë së ulë. E njëjta konstatoi se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar, si dhe për rehabilitim fiziko-terapeutik. Gjykata ua fali besimin ekspertizave të lartpërmendura të punuara nga Dr. Luan Kuqi – ortoped dhe Dr. Sh..... H..... – psikiatër, pasi që konsideroi se të njëjtat përmbajnë elementet e nevojshme, të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura është përgjegjëse për dëmin që i është shkaktuar paditësit në bazë të auto përgjegjësisë. Andaj, në përputhje me nenin 136, 159, 169, 173, dhe 183 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), gjykata e aprovoj pjesësisht kërkespadinë e paditësit edhe e detyroi të paditurën t’ia kompensoj paditësit dëmin e shkaktuar në aksidentin e trafikut. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendimin e saj e mbështeti në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jomaterial, gjegjësisht për dhimbjet fizike, frikën, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë dhe se lartësia e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me natyrën e lëndimeve, pasojat e lëndimeve dhe provat e administruara (mendimi i ekspertëve mjekësor).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ndërgjyqëse me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërisht të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për themelësinë e pjesërisht të kërkesëpadisë në lidhje me

bazën juridike të kërkesëpadisë së paditëses (baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuar nga pala e paditur, por vetëm lartësia e saj), ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka është provuar përmes ekspertizës mjekësore, lëndimin dhe pasojat për paditësin, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara, për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket konstatimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të ligjit material. Duke shqyrtuar pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit, Gjykata e Apelit vlerëson se janë pretendime ankimore të paqëndrueshme dhe pabazuara, pasi e paditura gjatë procedurës nuk e kishte kontestuar kërkesëpadinë për nga baza dhe e njëjta është e provuar edhe me prova materiale. Ndërkaq, edhe pretendimet ankimore lidhur me lartësinë e shumave të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensimin e dëmit jo material dhe material si shuma shumë të larta (pretendimet e të paditurës), përkatësisht të ulëta (pretendimet e paditësit) se nuk janë në harmoni me natyrën e lëndimeve të pësuar, gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat në bazë të vlerësimeve profesionale të ekspertëve mjekësor në ekspertizat e tyre të cilët kanë konstatuar lëndimet e pësuar nga paditësi janë të natyrës së rëndë trupore. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe në bazë të nenin 323 të LPK-së, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkëlqes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Si rrjedhojë nga arsyet e cekura si më lartë edhe pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shuma të ulëta, përkatësisht të larta në raport me lëndimet e pësuar nga paditësi, janë plotësisht të pabazuara.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe në harmoni edhe me praktikat gjyqësore të gjykatave të Kosovës sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë

dhe për shpenzimet e shërimit e cila po ashtu është vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, e cila konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë (për kohën e cekur në ekspertizë) atëherë vërtetohet se palës së dëmtuar i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me vendosjen lidhur me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së i cili shprehimisht përcakton “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e pjesërishme të kërkesëpadsisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur bazueshmëria e pjesërishme e kërkesëpadsisë së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadija e paditësit në rastin konkret është pjesërisht e themeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditësit dhe të paditurës janë të pathemelta.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që e njëjtat është gjykuar në përputhje me nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1, pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10704/21 me datë 21.05.2024

**Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi**